


QASJA NË INFORMACIONE DHE NARRATIVËT ONLINE GJATË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË KOSOVË NË VITIN 2026

FOKUS NË KOMUNITETIN
SERB





Porositësi i hulumtimit: OJQ AKTIV
Adresa: Mbreti Petar 183a, Mitrovicë
Veriore
E-mail: info@ngoaktiv.org
Uebajti: www.ngoaktiv.org
Mitrovicë, 2026.

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovë për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e OJQ Aktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, apo Suedisë.

HYRJE

Kjo analizë ofron një pasqyrë të mjedisit informativ gjatë zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, të mbajtura në qershor 2026, me fokus te narrativat online, dezinformimi, qasja në informacionet zyrtare dhe realizimi i të drejtave gjuhësore. Qëllimi i monitorimit ishte të vlerësonte mënyrën se si qytetarët, veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, u informuan gjatë procesit zgjedhor, si dhe të identifikonte sfidat dhe praktikat pozitive që karakterizuan këtë cikël zgjedhor.

METODOLOGJIA

Monitorimi u zhvillua gjatë gjithë periudhës zgjedhore, duke filluar nga aktivitetet përgatitore që i paraprinë fillimit zyrtar të fushatës dhe deri në certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Analiza përfshiu komunikimin zyrtar të institucioneve të përfshira në procesin zgjedhor, informacionet e disponueshme publikisht, raportimet mediale dhe përmbajtjet e publikuara në rrjetet sociale. Vëmendje e veçantë iu kushtua qasshmërisë së informacionit në gjuhën serbe dhe shqipe, si dhe identifikimit të narrativave dominuese online dhe pretendimeve kontestuese që shoqëruan procesin zgjedhor.

ZGJEDHJET NË SHIFRA

TREGUESI	TË DHËNAT
Data e mbajtjes së zgjedhjeve	7 qershor 2026.
Periudha e fushatës zgjedhore	28 maj - 7 qershor
Numri i subjekteve politike	21
Numri i kandidatëve	902
Numri i përgjithshëm i banorëve (Regjistrimi 2024)	1,602,515
Numri i përgjithshëm i votuesve	2.092.174
Numri i votuesve me të drejtë vote në Kosovë	1.959.962
Numri i përgjithshëm i votuesve që votuan	812.345
Certifikimi i rezultateve	07 korrik 2026.

GJETJET KRYESORE

Qasja në informata gjatë procesit zgjedhor nuk ishte e siguar në mënyrë të barabartë në të dy gjuhët zyrtare

Monitorimi tregoi se gjatë procesit zgjedhor votuesit kishin qasje në informacionet bazë lidhur me regjistrimin, votimin, afatet zgjedhore dhe rezultatet. Megjithatë, qasja në informata nuk ishte e njëjtë për përdoruesit e gjuhës serbe dhe shqipe, pavarësisht se të dyja janë gjuhë zyrtare në Kosovë.

Analiza e faqes zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tregoi dallime ndërmjet versioneve në gjuhën serbe dhe shqipe sa i përket disponueshmërisë së dokumenteve, të dhënave statistikore dhe informacioneve mbi proceset e mëparshme zgjedhore. Monitorimi identifikoi gjithashtu mangësi teknike në versionin serbisht të faqes, përfshirë lidhje jofunksionale, të dhëna kontakti të papërditësuara, **përmbajtje në gjuhën shqipe, gabime gjuhësore dhe drejtshkrimore**, si dhe vështirësi në qasjen në disa shërbime të destinuara për votuesit. Disa vendime dhe dokumente u publikuan me vonesë në gjuhën serbe ose nuk ishin të disponueshme në të njëjtën kohë si në versionin shqip të faqes. Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve ende **nuk janë të disponueshme në versionin serbisht të faqes**.

Njëkohësisht, monitorimi evidentoi edhe një përparim në komunikimin përmes rrjeteve sociale. Gjatë fushatës zgjedhore, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve informative, përfshirë materialet vizuale, videot dhe udhëzimet për votuesit, ishte e disponueshme edhe në gjuhën serbe, çka përbën një përmirësim krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore.

Faktet kryesore



U vunë re dallime ndërmjet versioneve në gjuhën serbe dhe shqipe të faqes zyrtare të KQZ-së.



Disa dokumente dhe informacione nuk ishin të disponueshme njëkohësisht, ose nuk ishin fare të disponueshme, në të dyja gjuhët zyrtare.



Rrjetet sociale përbënin një shembull pozitiv të përmirësimit të komunikimit shumëgjuhësh.

Realizimi i të drejtës së votës së personave të zhvendosur dhe votimi jashtë Kosovës

Gjatë procesit zgjedhor u rihap çështja e realizimit të së drejtës së votës për personat e zhvendosur që kanë të drejtë vote në Kosovë. Ashtu si në ciklet e mëparshme zgjedhore, një numër i madh i votuesve të zhvendosur me dokumente të vlefshme personale të Kosovës udhëtoi nga Serbia në Kosovë për të votuar në vendvotimet e rregullta. Në prag të zgjedhjeve, [Komisariati për Refugjatë dhe Migrim i Republikës së Serbisë](#) publikoi një thirrje publike dhe hapi një linjë të posaçme telefonike për ofrimin e informatave lidhur me ushtrimin e të drejtës së votës.

Sipas të dhënave të [Komisionit Qendror të Zgjedhjeve](#), në këtë proces zgjedhor të drejtën e votës e kishin 2.092.174 votues. Prej tyre, 1.959.962 ishin caktuar të votonin në vendvotimet në Kosovë, ndërsa 132.212 ishin të regjistruar për votim jashtë Kosovës. Brenda kësaj kategorie, 100.970 votues ishin regjistruar për votim me postë në një adresë jashtë Kosovës, 3.518 për pranimin e fletëvotimit në një adresë në Kosovë, ndërsa 27.724 ishin regjistruar për të votuar në përfaqësitë diplomatike.

Mënyra e ushtrimit të së drejtës së votës për personat e zhvendosur që jetojnë në Serbi ndryshonte nga modalitetet e ofruara për shumicën e votuesve të regjistruar për votim jashtë Kosovës, të cilët mund të votonin me postë ose në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore. Megjithëse kjo çështje përsëritet në disa cikle zgjedhore dhe kërkon rregullisht organizimin e ardhjes së një numri të madh të votuesve të zhvendosur në Kosovë, ajo vazhdon të mos jetë objekt i një debati serioz publik apo institucional mbi zgjidhjet e mundshme afatgjata.

Gjatë këtij procesi zgjedhor nuk pati iniciativa të dukshme nga institucionet në Prishtinë, autoritetet në Serbi apo aktorët ndërkombëtarë të orientuara drejt gjetjes së një modeli të qëndrueshëm që do ta lehtësonte ushtrimin e së drejtës së votës për këtë kategori votuesish.

Narrativat politike dominuese dhe pretendimet kontestuese formësuan debatin online gjatë procesit zgjedhor

Në periudhën që i parapriu zgjedhjeve, gjatë fushatës zgjedhore dhe pas shpalljes së rezultateve, hapësira online u karakterizua nga një shkëmbim intensiv i mesazheve politike, akuzave dhe narrativave të kundërta. Krahas informatave zyrtare të publikuara nga institucionet përgjegjëse, një pjesë e konsiderueshme e debatit publik u zhvillua përmes mediave, rrjeteve sociale dhe deklaratave zyrtare të akterëve politikë.

Monitorimi tregoi se narrativat dominuese ishin të përqendruara në katër tema kryesore: legjitimitetin e rezultateve zgjedhore, rregullsinë e procesit të votimit, presionet politike ndaj votuesve, si dhe pretendimet për keqpërdorimin e burimeve publike gjatë fushatës. Në shumicën e rasteve bëhej fjalë për pretendime politike që ishin objekt i ankesave institucionale, përgënjeshtërimeve publike ose interpretimeve të kundërta nga palët e përfshira.

Presioni ndaj votuesve dhe ndikimi politik

Një nga narrativat dominuese kishte të bënte me pretendimet për presion politik ndaj votuesve të komunitetit serb. Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe zyrtarët e Republikës së Serbisë paraqitën pretendime të kundërta lidhur me ndikimin mbi votuesit dhe rolin e institucioneve shtetërore gjatë procesit zgjedhor. **Ndërsa kryeministri në detyrë, Albin Kurti,** deklaroi se serbët ishin nën presion për të mbështetur Listën Serbe, **zyrtarët e Republikës së Serbisë dhe të Zyrës për Kosovën dhe Metohinë** pohuan se aksionet policore dhe arrestimet e serbëve përbënin përpjekje për frikësimin e votuesve serbë dhe për t'i dhënë mbështetje politike kryetarit të partisë Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Nenad Rashiq.

Masat sociale gjatë periudhave zgjedhore si temë e përsëritur e debatit publik

Një nga modelet e identifikuara gjatë monitorimit lidhet me miratimin e masave të njëhershme sociale dhe financiare menjëherë para zgjedhjeve. Vendime të ngjashme janë evidentuar gjatë disa cikleve zgjedhore, përfshirë zgjedhjet lokale të tetorit 2025 dhe **zgjedhjet parlamentare të dhjetorit të po atij viti.**

Në të tri rastet, këto masa u shoqëruan me debate publike, në të cilat **partitë opozitare** dhe aktorë të tjerë vunë në pikëpyetje kohën e miratimit të tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi trupin elektoral, ndërsa Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka theksuar se bëhej fjalë për masa të mbështetjes sociale dhe ekonomike për qytetarët.

Masat sociale të përsëritura në prag të zgjedhjeve

CIKLI ZGJEDHOR ↓	MASA ↓	KOHA E MIRATIMIT ↓	REAGIMET ↓
ZGJEDHJET LOKALE 2025 →	Ndihmë e njëhershme prej 100 € për studentët dhe fonde për programin e bursave për mobilitet (rreth 26 milionë € gjithsej)	Në prag të zgjedhjeve lokale në tetor	Opozita dhe një pjesë e publikut vunë në pikëpyetje kohën e marrjes së vendimit, ndërsa Qeveria theksoi se bëhej fjalë për një masë mbështetëse për studentët.
ZGJEDHJET PARLAMENTARE (DHJETOR) 2025 →	Ndihmë e njëhershme prej 100 € për fëmijët dhe pensionistët	Në prag të zgjedhjeve parlamentare	Partitë opozitare e vlerësuan masën si përpjekje për të ndikuar te votuesit, ndërsa Qeveria deklaroi se bëhej fjalë për mbështetjen tradicionale në fund të vitit.
ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2026 →	Ndihmë e njëhershme prej 100 € për pensionistët, fëmijët, studentët dhe të punësuarit në sektorin privat, së bashku me rritjen e disa përfitimeve sociale	Menjëherë para zgjedhjeve të 7 qershorit 2026	Partitë opozitare, një pjesë e organizatave të shoqërisë civile, sindikatat dhe komuniteti i biznesit e vlerësuan këtë si keqpërdorim të burimeve publike, ndërsa Qeveria i hodhi poshtë këto pretendime dhe i paraqiti masat si mbështetje sociale për qytetarët.

PËRFUNDIM

Monitorimi i mjedisit informativ gjatë zgjedhjeve parlamentare në Kosovë në vitin 2026 tregoi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përmirësuar disa segmente të komunikimit me qytetarët, veçanërisht përmes përdorimit më intensiv të kanaleve digjitale dhe pranisë më të madhe të përmbajtjes në gjuhën serbe në rrjetet sociale. Në të njëjtën kohë, analiza tregoi se qasja e barabartë në informata në të dyja gjuhët zyrtare ende nuk është siguruar plotësisht, kryesisht për shkak të dallimeve në përmbajtje dhe funksionalitet ndërmjet versioneve gjuhësore të platformave zyrtare.

Monitorimi tregoi gjithashtu se debati publik gjatë procesit zgjedhor u formësua në masë të madhe nga narrativat politike dhe pretendimet e kundërta lidhur me rregullsinë e zgjedhjeve, presionet politike dhe përdorimin e burimeve publike. Shumica e këtyre narrativave buronin nga deklaratat e akterëve politikë, ndërsa shtrirja e tyre u zgjerua më tej përmes raportimit mediatik dhe rrjeteve sociale. Për këtë arsye, komunikimi institucional i shpejtë, transparent dhe shumëgjuhësh kishte një rol kyç në sigurimin e informatave të besueshme.

Gjetjet e këtij monitorimi tregojnë se forcimi i besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor nuk varet vetëm nga zhvillimi i zgjedhjeve në përputhje me ligjin, por edhe nga cilësia e mjedisit informativ, qasja e barabartë në informata dhe aftësia e institucioneve për t'iu përgjigjur në kohë pretendimeve kontestuese dhe dilemave të publikut.

REKOMANDIME

- ✓ Të sigurohet publikimi i njëkohshëm i të gjitha informatave zgjedhore, vendimeve dhe rezultateve në gjuhën serbe dhe shqipe, në përputhje me detyrimet ligjore për përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.
- ✓ Të krijohet një mekanizëm i rregullt për kontrollin e cilësisë së përkthimeve, funksionalitetit të versioneve gjuhësore të faqeve zyrtare të internetit dhe përditësimit të përmbajtjes së dedikuar për votuesit.
- ✓ Të vazhdohet me përmirësimin e komunikimit shumëgjuhësh në rrjetet sociale, duke zbatuar standarde që garantojnë cilësi dhe qasshmëri të barabartë të përmbajtjes në të dyja gjuhët zyrtare.
- ✓ Të forcohet komunikimi proaktiv institucional gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor, në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohen në kohë informata të sakta dhe të zvogëlohet hapësira për përhapjen e pretendimeve të pakonfirmuara ose dezinformuese.
- ✓ Të zhvillohen procedura të qarta për reagim të shpejtë ndaj informatave që mund të ndikojnë në besimin e publikut në procesin zgjedhor, duke publikuar rregullisht sqarime dhe fakte relevante sa herë që është e nevojshme.
- ✓ Të përmirësohet qasshmëria e informatave zgjedhore për komunitetet joshumicë dhe votuesit që votojnë jashtë Kosovës, përmes përmbajtjeve informative të përshtatura dhe qasjes më të lehtë në shërbimet dhe dokumentacionin përkatës.



NGOAKTIV.ORG